

VENDIM
Nr. 207, datë 16.12.2019

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË OST SHA, PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
E ERE-s NR. 43, DATË 15.3.2017, MBI MIRATIMIN PËRFUNDIMTAR TË
CERTIFIKIMIT TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE OST SHA, NË PËRPUTHJE ME NENIN 54, PIKA 6, TË
LIGJIT NR. 43/2015, “PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE” DHE NENIN 9,
PIKA 6, TË DIREKTIVËS 72/2009 EC, MBAS MARRJES SË OPINIONIT TË
SEKRETARIATIT TË KOMUNITETIT TË ENERGJISË**

Në mbështetje të nenit 3, pika 8 dhe neneve 16; 54 dhe 58, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 53, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; neneve 3; 6; 8 dhe 10, të “Rregullave për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 154, datë 11.12.2015, të bordit të ERE-s, nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 114/14, datë 10.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e OST sh.a., për shtyrjen e afatit të pikës 2, të vendimit të ERE nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, ‘Për sektorin e energjisë elektrike’ dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC, mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 43, datë 15.3.2017, bordi i ERE-s është shprehur “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, ‘Për sektorin e energjisë elektrike’ dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC, mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”.

- OST sh.a, me shkresën nr. 8106 prot., datë 10.12.2019, protokolluar në ERE me nr. 630/9, datë 10.12.2019, i është drejtuar ERE-s me kërkesën për shtyrjen me 6 (gjashtë) muaj të afatit të plotësimit të kushteve të parashikuara në vendimin e certifikimit.

- Rezulton, nga raportimet e OST sh.a, se ka plotësuar të gjitha kushtet e certifikimit përveç atij që lidhet me “Bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimi i kompetencave te Ministria e Ekonomisë”.

- OST-ja ka bërë të gjitha përpjekjet për plotësimin e kushtit sa i përket bashkëveprimit ndërinstitucional me qëllim përmbushjen e këtij kushti.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sugjeron shtyrjen me të paktën 3 (tre) muaj të afatit të plotësimit të pikës 2, të vendimit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, ‘Për sektorin e energjisë elektrike’ dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC, mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, deri në përfundimin e procesit të miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë, të ndryshimeve në ligjin nr. 43/2015, të ndryshuar, për të plotësuar detyrimin për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimin e kompetencave te Ministria e Ekonomisë.

- OST sh.a. sugjeron shtyrjen me të paktën 6 (gjashtë) muaj të afatit të plotësimit të pikës 2, të vendimit të ERE nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit

nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC, mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, deri në përfundimin e procesit të miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë, të ndryshimeve në ligjin nr. 43/2015, të ndryshuar, për të plotësuar detyrimin për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimin e kompetencave të Ministria e Ekonomisë:

- MIE, me shkresën nr. 9809/2, datë 3.12.2019, protokolluar në ERE me nr. 737/2, datë 4.12.2019, ka përcjellë edhe shkresërisht praktikën e komunikimit të datës 16.10.2019, me anë të të cilave është dërguar për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë projektligji i sektorit të energjisë me ndryshimet e propozuara, nëpërmjet sistemit e-aktet.

- Që një projektligj të marrë fuqi ligjore ai duhet të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë.

- Përpara se ky projektligj të paraqitet në Kuvend, ai duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave, si dhe të përcillet në komisionet përkatëse parlamentare, e së fundmi t’i nënshtrohet miratimit në seancë plenare në Kuvend.

- Duke vlerësuar se për shkak të fatkeqësisë natyrore që goditi Shqipërinë, e gjithë qeveria shqiptare është e angazhuar në adresimin e problematikave që lidhen me korrigjimin e pasojave të shkaktuara nga situata, dhe adresimi i çështjeve që lidhen me gjendjen e jashtëzakonshme do të ketë prioritet mbi çështje të tjera, mendojmë se afati 6 mujor i propozuar nga OST sh.a. mund të jetë i mjaftueshëm për finalizimin e miratimit të projektligjit.

- Si e tillë, kushti i vendimit nr. 43, datë 15.3.2017, që lidhet me “Bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimin e kompetencave të Ministria e Ekonomisë”, do të konsiderohet i plotësuar, pas miratimit të projektligjit në fjalë.

- Kërkesa e OST sh.a. e parashtruar edhe në seancën dëgjimore të organizuar nga ERE-ja, është depozituar në ERE me shkresën nr. 8106 prot., datë 10.12.2019, protokolluar në ERE me nr. 630/9, datë 10.12.2019, dhe duke marrë në konsideratë që afati i vendosur në vendimin e bordit të ERE-s nr. 47, datë 19.3.2019, plotësohet në datën 15.12.2019, shqyrtimi i kësaj kërkesë përpara përfundimit të afatit, plotëson kushtet sa më sipër, në zbatim edhe të nenit 53, të Kodit të Procedurave Administrative, i cili citon: “afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e OST sh.a. për shtyrjen e afatit të zbatimit të pikës 2, të vendimit të ERE nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, ‘Për sektorin e energjisë elektrike’ dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC, mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, deri në datën 16.6.2020.

2. Ngarkohet Drejtoria e Çështjeve Ligjore t’i përcjellë këtë vendim OST sh.a, Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi, në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti